Vetë Pejgamberi alejhis-selam kur u sëmur e caktoi Ebu Bekrin të del si imam në namaz;
Kur një grua e pyeti Pejgamberin alejhis-selam: "Po sikur të mos të të gjejë ty (pra, nëse nuk je gjallë) pas një viti, çfarë të bëjë? Pejgamberi alejhis-selam iu përgjigj: "Shko tek Ebu Bekri"

189 Trego së paku 4 faktorë që ndikuan në pranimin e Islamit nga ana e shqiptarëve?
Faktori fetar, faktori moral, faktori kulturor, faktori shkencor, faktori ekonomik, faktori shoqërorë etj.

190 Cilat shtete e përbëjnë Beneluksin?
Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu.

191 Nga 10 personat (El-asheratul-mubesh-sherine bil-xhen-neh) të cilët qysh në dunja Muhammedi alejhis-selam i përgëzoi me Xhen-net numëro së paku 4 prej tyre?

Ebu Bekri r. a.,
Umeri r. a.,
Othmani r. a.,
Aliu r. a.,
Zubejri r. a.,
Abdur-rahman bin Aufi r. a.,
Sa'd bin Ebi Vek-kasi r. a.,
Seid bin Zejdi r. a.,
Ebu Ubejdeh bin El-Xher-rah r. a.,
Talhah bin Ubejdull-llah r. a.

192 Pejgamberi alejhis-selam në një Hadith të Imam Ahmedit, thotë: "M'i garantoni 6 gjëra dhe ju garantoj Xhen-netin...". Numëro së paku 4 gjëra prej tyre!

Të flisni me drejtësi;
Të zbatoni atë që premtoni;
Të çoni në vend amanetin;
Ruani organet gjenitale;
Largoni shikimin nga Harami; dhe
Frenoni duart e juaja prej Haramit;

193 Trego së paku 4 Sun-nete të abdestit sipas Medh'hebit tonë Hanefij?

Larja e duarve deri mbi nyje, posaçërisht pas zgjimit nga gjumi;
2.. Të fillohet me përmendjen e emrit të All-llahut Fuqplotë;
Pastrimi 3 herë i gojës e i hundës;
Misvaku-pastrimi i dhëmbëve;
Fërkimi në mes gishtërinjëve;
Pastrimi i çdo pjese të përsëritet 3 herë;
Pastrimi i qafës me dorë të lagur pa fytin.

194 Trego objektet fetare (së paku 4) të Bashkësisë Islame në Maqedoni ?

Xhamitë;
Mesxhidet;
Mejtepet;
Teqet;
Gusulhanet;
Varrezat;
Tyrbet.

195 Cila është maja më e lartë në botë dhe ç'do të thotë?

Maja Monteverest, ose Çome Lungma që do të thotë: "Nëna e të gjitha maleve", me një lartësi 8882 metra.

196 Përmend së paku 5 nene të Kushtetutës së Shtetit Islam në Medine që paraqet Kushtetutën e parë të shkruar në historinë e së drejtës?

Të gjithë Muslimanët janë një ummet- popull.

Të gjithë Muslimanët janë të obliguar ta luftojnë të keqen, të gjithë sikur një.

Muslimani nuk guxon të mbysë Muslimanin për shkak të Jomuslimanit.

Muslimani nuk guxon t'i ndihmojë Jomuslimanit kundër Muslimanit.

Garanca e All-llahut xhel-le shanuhu është e njëjtë për të gjithë, por Ai më së pari i merr nën mbrojtje më të dobët prej jush.

Ai që është kundër Muslimanëve-të gjithë Muslimanët duhet të ngriten kundër tij.

Ai që e mbyt Muslimanin i cili nuk është gjykuar me vdekje (d. m. th. nuk ka bërë diç që duhet të mbytet) edhe ai do të jetë i mbytur, përveç nëse ia falin trashëgimtarët e njeriut të mbytur.

Ata hebrenj që na pasojnë, do të kenë ndihmë prej nesh, dhe te ne shembul të mirë, përveç atyre që kanë bërë dhunë dhe që janë ndihmuar mes veti kundër nesh.

Hebrenjtë do ta kenë ekonominë e vetë, ndërsa Muslimanët të vetën.

Edhe njëra edhe tjetra palë janë të obliguara ta mbrojnë lirinë e përbashkët nga armiku i jashtëm.

Hebrenjtë duhet të kenë marrëdhënie të mira me muslimanët nëse këta gjenden në luftë.

197 Trego së paku 4 transmetues më të njohur të Hadithit nga gjenerata e Sahabeve?

Ebu-Hurejreja r. a;

Abdull-llah Ibni Umeri;

Enes Ibni Maliku;

Aisheja r. a. a.;

Xhabir Ibni Abdull-llahu r. a.;

Abdull-llah Ibni Ab-basi r. a.;

Abdull-llah Ibni Mes'udi r. a.;

Ebu Seid El-Hudriu r. a. ;

198 Trego definicionin e Kur'anit në aspektin terminologjik?

Kur'ani është fjala e All-llahut xhel-le shanuhu mrekulli pa konkurrencë, i zbritur Muhammedit

alejhis-selam përmes Xhibrilit alejhis-selam i transmetuar në mënyrë më të besueshme, leximi i të cilit është ibadet.

199 Trego 5 emra të Ditës së Kijametit që cekën në Kur'anin Kerim?

Jevmul-Kijame - Dita e Gjykimit;

Jevmul-Ahir - Dita e Fundit;

Jevmul Huruxh - Dita e Daljes (prej varreve);

Es-Saatu - Momenti;

Jevmud-din – Dita e Llogarisë;

Jevmul-Hasre – Dita e Dëshpërimit;

Jevmul-Hisab – Dita e Përgjegjësisë;

Jevmul-Xhem'i – Dita e Tubimit; etj.

200 Nga rrjedh fjala *Evropë*?

Nga fjalët e dy popujve të vjetër Fenikas dhe Asirobabilonas "Ereb" që d. t. th: "Toka ku perëndon Dielli".

201 Sipas mitologjisë greke, Afrodita është krijuar nga shkuma e detit?

- Po

202 Fagot është instrument muzikor me frymë nga metali?

- Jo (nga druri)

203 Pind është masiv malor në Shqipëri?

- Jo (Greqi)

204 Jeremiu është parashikuesi i zhdukjes së Judejëve?

- Po

205 Origami është mjeshtri japonez e bërjes të figur. Nga letra?

- Po

206 Sekvoja mund të jetojë deri në 4000 vjet?

- Po

207 Sër Ernest Rutherford është një nga themeluesit e fizikës nukleare moderne dhe kimisë nukleare?

- Po

208 Vullkani më i lartë i vjetër i ujdhesave japoneze (ujdhesa Honshu), me lartësi 3778 m. erupcioni i fundit i të cilit ka qenë më vitin 1707, quhet Fuxhimuri?

- Jo (Fuxhijama)

209 Hidraulika është shkenca mbi shtypjen dhe lëvizjen e trupave të lëngët, si dhe për përdorimin teknik të ligjshmërive hidromekanike?

- Po

210 Artur Shopenhauer është filoz. gjerman, mësimi i të cilit e bashkon inspiracionin e Kantit me atë pesimistiko- budistik? - Po

211 Orgist Roden është piktor francez, njëri nga përfaqës, më eminent të Rokoko-së?

- Jo(Skulptor)

212 Heba në mitol. Helene ka qenë hyjnesha e rinisë. Ajo ka qenë vajza e Zeusit dhe e Herës, kurse Heraklit kur është emëruar zot, është martuar me të?

- Po

213 Themeluesi i xhudos është Xhigoro Kano, që nga viti 1897?

- Po

214 Iniciator i revistës më të vjetër në botë "Zhurnali i shkencëtarëve" është Denis Solo, në Paris 1665?

- Po

215 Biotop quhet hapësira e ngushtë në të cilën ekzistojnë mundësi për jetesë për një numër të caktuar të bimëve dhe shtazëve.

- Po

216 Kabilët quhen disa fise që kanë jetuar në viset malore të Amerikës Veriore.

- Jo(të Afrikës veriore)

217 Kur u mbajt kongresi i Berlinit?

- 13 qershor, 1878.

218 Kur u mbajt Lidhja e Prizrenit?

- 10 qershor, 1878.

219 Cilat shtete e përbënin " Lidhjen tripalëshe"?

- Gjermania, Austria dhe Hungaria.

220 Kur u shpall Shqipëria Mbretëri?

- 1 shtator, 1928.

221 Trego shkakun kryesor për fillimin e Luftës së Parë Ballkanike!

- Shkaku kryesor ishte ndarja e sërishme e botës midis shteteve imperialiste.

222 Cili ishte shkaku kryesor i fillimit të Luftës së Parë Botërore?

- Shkaku i Luftës së Parë Botërore ishte vrasja e trashigimtarit të Fronit Austra-hungarez, Franc Ferdinandit nga ana e Gavrillo Principit.

223 Kur filloi Revolucioni i Madh Borgjez francez?

- Më 14 korrik, 1789.

224 Kur u shpall Perandor Napoleon Bonaparta?

- Në vitin 1804.

225 Ç' është Imperializmi?

- Faza më e lartë e kapitalizmit është imperializmi.

226 Kur u shpall bashkimi i Gjermanisë dhe ku?

- Në janar të vitit 1871 në Oborin e Versajës.

227 Ç' nënkuptoni me fjalën "autokton"?

- Autokton do të thotë: banorë të lindur e të formuar në trojet ku jetojnë.

228 Numëro perandorët romak me prejardhje ilire!

- Diokleciani, Konstandini i Madh etj.

229 Sa vjet më parë se evropjanët arabët përdornin busolla edhe atë prej hekurit magnetik, në trajtë peshku?

- 800 vjet.

230 Nga e kanë origjinën Kastriotët?

- Nga Hasi i Kukësit.

231 Numëro djemtë e Gjonit dhe Vojsavës!

- Stanisha, Reposhi, Konstandini dhe Gjergji.

232 Si iu vu emri Gjergjit dhe çfarë titulli mori?

- Iu vëndua emri Skender, fitoi titullin be-Skenderbeu.

233 Në cilin vit vdiq Skenderbeu?

- Në vitin 1907.

234 Lufta e II Botërore filloi me sulmin e Gjermanisë ndaj Polonisë. Kur ndodhi kjo?

- Më 1 shtator 1939.

235 Ç' është Këshilli evropian, kur dhe ku u themelua?

- Këshilli evropian është Organizatë Rajonale evropiane e themeluar në vitin 1949 në Londër.

236 Cilët janë shkrimtarët shqiptarë që kanë shkruar me alfabet arab?

- (Nazim Frakulla) Ibrahim Nezimi, Hasan Zyko Kamberi, Zejnel Bastari, Muhamed Kyçyku-Çami, Rexhep Vokë-Tetova etj.

237 Në cilin qytet është ngritur ujësjellësi i parë në Ballkan?

- Në Sarajevë.

238 Kush i shkroi poemat "Jusufi dhe Zelihaja" dhe "Ervehaja"?

- Muhamed Kyçyku.

239 Cili shqiptar themeloi Egjiptin modern?

- Muhamed Ali Pasha.

240 Cili Oqean është mesatarisht më i thellë?

- Oqeani i Qetë.

241 Sa është shpejtësia e erës që quhet Tornado?

- Arrin shpejtësi deri më 45 km në orë.

242 Cili është lumi më i gjatë në Afrikë dhe sa është gjatësia e tij?

- është Nili, me 6500 km gjatësi.

243 Cili planet është më afër e cili më larg sistemit Diellor?

- Planeti më i afërt është Merkuri, kurse më i largët është Plutoni.

244 Trego kanjonin më të njohur në botë!

- është Kolorado në SH.B.A.

245 Mes cilave shtete gjendet Lihtenshtajni?

- Mes Zvicrës dhe Austrisë.

246 Sa shtete numëron Bashkimi Europjan?

- 25 shtete.

247 Trego vullkanin më të njohur në Itali!

- Vezuvi.

248 Trego kufizimin e Kuvajtit!

- Me Irakun dhe Arabin Saudite.

249 Trego malin më të lartë në Afrikë?

- Kilimanxharo me 6010 metra lartësi.

250 Nëpër sa shtete kalon lumi Danub?

- Nëpër 8 shtete.

251 Cila ngushticë e ndan Evropën me Afrikën?

- Ngushtica e Gjibraltarit.

252 Cili është kontinenti më i madh e cili më i vogël?

- Kontinenti më i madh është Azia, kurse më i vogël Australia.

253 Sa planeta e përbëjnë sistemin diellor?

- Merkuri, Venera, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani, Neptuni dhe Plutoni.

254 Prej çka përbëhet vullkani?

- Kraterit, kupës dhe kanalit rrjedhës.

255 Cila është ngushtica më e gjatë në Maqedoni?

- Ngushtica e Demir Kapisë (dera e hekurt).

256 Cili prej 7 kontinentëve ka më së paku banorë?

- Antartiku.

257 Sa oqeane ka në botë, numëroji!

- Oqeani Atlantik, Paqësorë, I Ngrirë, I Veriut dhe Indian.

258 Trego ujdhesën më të madhe në Afrikë!

- Madagaskar.

259 Trego gjatësinë e lumit Vardar dhe sa i takon Maqedonisë prej saj!

- Lumi Vardar është i gjatë 388 km dhe prej saj Maqedonisë i takon 301 km.

260 Sa është i gjatë lumi Danub dhe ku derdhet?

- Danubi është i gjatë 2 860 km dhe derdhet në Detin e Zi.

261 Ku derdhet lumi Misisipi?

- Në gjirin e Meksikës.

262 Në cilin Det shtrihet Stambolli?

- Në Detin Marmarë.

263 Cilët shtete e përbëjnë ishullin e Britanisë së Madhe?

- Anglia, Skocia, Uells dhe Irlanda Veriore.

264 Cili planet është më larg Diellit?

- Plutoni.

265 Në cilin kontinent kalon Ekuadori?

- Në ujdhesat e Azisë, Afrikë dhe në Amerikën Jugore.

266 Trego shtetin më të madh në Afrikë?

- Sudani.

267 Si quhet ngushtica që gjendet midis detit Marmarë dhe Detit të Zi?

- Ngushtica e Bosforit.

268 Si quhet pika më e lartë në kupën qiellore mbi vrojtuesin?

- Zenit.

269 Numëro tre shtetet evropiane që kanë më shumë vullkane?

- Islanda, Italia dhe Greqia.

270 Sa është sipërfaqja e Tokës?

- 510 milionë km²

271 Si quhet paralelja më e gjatë?

- Ekuadori.

272 Çka quajmë Meridian?

- Vija që lidh dy polet quhet Meridian.

273 Trego Meridianin fillestar?

- Meridiani fillestar është meridiani i Griniçit.

274 Çka quajmë Gjithësi ose Kozmos?

- Hapësira qiellore e pafund e mbushur me yje dhe trupa tjerë qiellor quhet Gjithësi ose Kozmos.

276 Ç'është delta?

- Delta është vendi para derdhjes ku lumi degëzohet në më shumë degë më të vogla.

277 Si i ndajmë liqejtë evropianë sipas formimit?

- Në liqene të fushëgropave, akullnajave, karstike, lumore dhe artificiale.

278 Në sa grupe ujdhesash e ndajmë Oqeaninë dhe cilat janë ato?

- Malezia, Mikronezia dhe Polinezia.

279 Sa është pika më e ulët dhe më e lartë mbidetare në Maqedoni?

- Pika më e ulët është 44 m, kurse më e lartë 2464 m.

280 Sa pellgjeve detare u takojnë lumenjtë e Maqedonisë?

- Tri pellgjeve detare. 1 Pellgu i Detit të Zi, 2 Pellgu i Detit Adriatik dhe 3 Pellgu i Detit Egje.

281 Ç'është Teorema e Pitagorës.?

- Në çdo trekëndësh kënddrejtë shuma e katrorëve të ndërtuar mbi katetë është e barbartë me katrorin e ndërtuar mbi hipotenuzë, pra $(a^2+b^2=c^2)$.

282 Kush e përdori i pari termin funksione trigonometrike?

- Termin funksion trigonometrik (sinus, kosinus, tangjent dhe kotangjent) së pari u përdorën nga shkencëtarët e vendeve Islame: All-Habish, All-Baktani dhe Abu-Il-Vafa.

283 Çfarë pozitash mund të kenë dy drejtëza?

- Drejtëzat mund të jenë: a) paralele, b) normale, c) të pjerët dhe d) të puthitshme.

284 Në qoftë se 6 veta kryejnë një punë për 15 ditë sa persona duhet të marrim për ta kryer të njëjtën punë për 10 ditë?

- 9 persona.

285 Nëna e dërgoi të birin t'i sjellë 7 litra ujë nga kroi. I dha dy enë; një të trelitërshe kurse tjetrën pesëlitërshe. Gjeje se në çfarë mënyre ka mundur i biri të matë 7 litra me anë të atyre dy enëve që i mori me vete!

- Njëherë e mbushë enën prej pesë litrash dhe e zbrazë në enën prej tre litra. Pastaj enën prej tre litrash e zbrazë në tokë, pjesën që ngel nga ena prej pesë litrave e zbraz në enën prej tre litrash dhe pastaj e mbush enën prej pesë litrash.

286 Numri më i madh i plotë negativ është? a) 1 b) 0 c) -1 d) -0

- c) -1

287 Numri $\frac{1}{2}$ i shprehur në përqindje është? a) 20% b) 50% c) 2% d) 1%

- b) 50%

288 Cillit pejgamber i zbriti Zeburi dhe çka përmbante?

- Zeburi i zbriti Davudit a.s. dhe kryesisht përmbante lutje, kurse në jetën e përditshme vazhdonte t'i aplikojë rregullat e shariatit të Musaut a.s.

289 Si quhen melekët të cilët do t'i marrin në pyetje njerëzit në varr?

- Munkir dhe Nekir.

290 Si është përkthimi i ajetit të pestë të sures El-Fatiha, (ihdinas-siratal mustekiim)

- Do të thotë: O, Zot na udhëzo në rrugë të drejtë!

291 Cila formë e besimit është m'ë pranuar te Allahu xh.sh.?

- Besii i cili bëhet me hulumtim (ixhtihad).

292 Pse shejtani u largua nga mëshira e Zotit?

- Për shkak se ra ndesh urdhrin të Allahut dhe nuk i bëri sexhde nderi Ademit a.s.

293 Ç' nënkuptojmë me fjalën "Amentubil-lah"?

- Është shprehje që përfshin besimin themelor Islam.

294 Si quhet namazi që falet para lindjes së diellit dhe sa regate ka?

- Quhet namazi i sabahut dhe ka katër rekate: 2 sunnet dhe 2 farz.

295 Çfarë sunneti është sunneti i parë i namazit të drekës?

- Sunneti i parë i drekës është sunneti Muek-kedeh, që do të thotë i fortë, të cilin pejgamberi a.s. vazhdimisht e ka falë.

296 Cili është agjërimi farz i domosdoshëm për çdo mysliman?

- Agjërimi farz është agjërimi gjatë Ramazanit dhe agjërimi i të gjitha llojeve të kefaretit (agjërimi për kompensimin e lëshimeve).

297 Si jepet Zekati për delet?

- Në katërdhjetë dele jepet një dele.

298 Deri kur duhet të jepet Sadaka-i Fitri?

- Sadakai-i Fitri duhet të jepet deri para faljes së namazit të Bajramit.

299 Cilat janë muajt e Haxh-xhit?

- Muajt e Haxh-xhit janë: Shevvali, Dhil-Kade dhe dhjet ditët e para të muajit Dhil-Hixh-xhe.

300 Si quhet vendi ku bëhet rukni më i rëndësishëm gjat Haxh-xhit?

- Arafat.

301 Kush ishte në kryje të Komitetit të Stambollit?

- Abdyl Frashëri.

302 Çdo të thotë mustehab?

-Një punë që është mirë ta punosh mirëpo nëse nuk e punon nuk ka gjynah.

303 Sa është afati i mbajtjes së mesteve kur personi gjendet në shtëpi e sa kur është në rrugë?

-Në shtëpi 24 orë , në rrugë 72 orë.

304 Ç'duhet bërë me foshnjen, sipas Islamit, pas lindjes së saj?

-Ti lexohet ezani në veshin e djathtë, ikameti në të majtë dhe të bëhet dua.

305 Çdo të thotë Imsak?

- Mbarimi i syfyrit dhe fillimi i agjërimit.

306 Si u përgjigjen shpirtërat në Ahd-i Mithak, në pyetjen e Allahut xh.sh.: “A nuk jam Unë Zoti i juaj”?

- Kalu Bela që d.m.th. “Po gjithsesi”.

307 Si quhet Xheneti, në të cilin u vendos Ademi a.s?

- Xhenneti Aden.

308 Biri i të cilit Pejgamber nuk hypi në anije me të atin?

- Biri i Nuhut a.s.

309 Si quhet faraoni, i cili luftoi kundër Musait a.s.

- Ramzesi i Dytë.

310 Si quhet vendi ku i erdhi shpallja Musait a.s.

- Turi Sina.

311 Cila shkencë ishte kulminante në kohën e Isait a.s. dhe cila ishte muxhizja e tij?

- Në kohën e Isait a.s. ishte e zhvilluar shkenca e medicinës dhe muxhiza e tij ishte ngjallja e të vdekurve.

312 Pse një vit gjatë periudhes së Mekkes e mori emrin Viti i dëshprimit?

- Për shkak se Pejgamberit a.s. i vdesin Mixha Ebu Talibi dhe shoqja Hatixhja r.a.

313 Në cilin vit sipas krishtit i vjen shpallja e parë Muhammedit a.s. dhe cilat ajete i zbresin?

- Në vitin 610 edhe atë 5 ajete të sures Alek.

314 Në cilin shtet u bë Hixhreti (shpërngulja) e parë e muslimanëve dhe si quhej mbreti i atij shteti?

- Shpërngulja e parë u bë në Abesini (Etiopi) kurse mbreti quhej Nexhashi (Negus).

315 Cila ishte lufta e parë e muslimanëve me mushrikët (politeistët) e Mekkes dhe kush ishte komandant i ushtrisë islame?

- Lufta e parë e muslimanëve me mushrikët ishte lufta e Bedrit, kurse komandant ishte Hazreti Hamza r.a.

316 Kush ishte halifi i tretë dhe si e thirnin atë shokët e pejgamberit?

- Halifi i tretë ishte Othmani r.a. a shokët e pejgamberit a.s. atë e thirnin Dhin –Nuvejin

317 Me çka është i përmendur Umeri r.a. e me çka Othmani?

- Umeri r.a. është i njohur me drejtësinë, kurse Othmani r.a. me butësinë e tij.

318 Kush ishte halifi më i drejtë në epokën Emevite dhe sa kohë qëndroi në pushtet?

- Omer ibn Abdulazizi, i cili në pushtet qëndroi dy vjet.

319 Në kohën e cilit halif dinastia Abasite arriti kulminacionin e vet?

- Në kohën e Harun er Rashidit.

320 Kush e themeloi medresën Nithanijje në Bagdad?

- Veziri Selam nizamu'l Mulki.

321 Kush luftoi trimërisht dhe e mposhti pushtetin e kryqtarëve në vendet islame?

- Salahud-din Ej-jubi.

322 Cili ishte hoxha më i ngritur i Tetovës në periudhën mes dy luftarëve botërore?

- Ishte Xhemil Efendiu.

323 Kur u hap Medrese-ja e Isa Beut në Shkup?

- Në vitin 1984.

324 Në çfarë moshe i ka ardhur Vajhi (shpallja) Muhammedit a.s.?

- Në moshën 40 vjeçare.

325 Në cilin vend iu shpall Muhammedit a.s. ajeti i parë Kur'anor?

- Në shpellën Hira.

326 Te kush ishte mysafir Muhammedi a.s. në Medine?

- Te Ebu Ej'jub El Ensariu.

327 Në cilën periudhë është përdorë si libër kryesor në mjekësi Kanuni i ibni Sinasë?

- Prej shekullit XII deri XVII.

328 Si e ka pasur emrin e vërtetë imam Buhariu?

- Muhammed ibn Ismail el Buhari.

329 Në kohën e cilit halif është bërë matja e gjatësisë së një shkalle të meridianit?

- Në kohën e Al-Memurit.

330 Sa banorë, xhami dhe hamame ka patë Kordoba në kohën e Abd-el Rrahmanit?

- Ka patë 500.000 banorë, 700 xhami, 300hamame.

331 Si quhet shehidi i parë nga Ensarite?

- Haris bin Suraka r.a.

332 Numëroni dhjetë personat (Ashere mubesh-shirin), të cilët qysh në dynja All-llahu xh.sh. ua garanton xhen-netin, për të cilën gjë i përgëzoi Muhamedi a.s.?

- 1) Ebu Bekri r.a. 2) Omeri r.a. 3) Othmani r.a. 4) Aliu r.a. 5) Zubejri r.a. 6) Abdur'rahman bin Afvi r.a. 7) Saad bin Ebi Vekas r.a. 8) Saad bin Zejdi r.a. 9) Ebu Ubejde bin Xharahi r.a. dhe 10) Talha bin Ubejdull-llahu r.a.

333 Në cilin shekull bota joislame filloi ta përdorë brushën për dhëmbë, gjë e cila për muslimanët ishte e obligueshme shumë shekuj më parë?

- Në shekullin nëntëmbëdhjetë.

334 Kush ka qenë munafiku (dyfytreshi) më i madh në Medinë?

- Abdullah bin Seluli.

335 Si quhet shkencatari, i cili, shumë kohë para Njutnit, e ka llogaritur diferencën e algjebres dhe gjeometrisë, ka bërë matjen e tokës dhe largësinë mes dy meridianëve?

- Thabit bin Kurra.

336 Si quhej shteti Islam në Spanjë?

- Endelus (Andaluzi).

337 Sa vjet zgjati embargoja ndaj muslimanëve?

- 3 vjet.

338 Cila është gruaja e vetme, emri i së cilës përmendet në Kur'an?

- Merjem, nëna e Isaut a.s.

339 Kush janë Hulefai Rashidinët?

- Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu r.a.

340 Si quhet Haxh-xhi Lamtumirës i Pejgamberit a.s.?

- Haxh-xhetu'l-Veda.

341 Me çka e shkatërroi popullin e Nuhit a.s. All-llahu xh.sh.?

- Me vërshim.

342 Cilët pejgamberë quhen Ulu'l-Azam?

- Nuhi, Ibrahim, Musa, Isa dhe Muhammedi a.s.

343 Gratë e cilëve pejgamber nuk e pranuan Islamin dhe u shkatërruan?

- Gruaja e Nuhit dhe e Lutit a.s.

344 Kush e ndërtoi Mesxhid-i Aksanë?

- Davudi a.s.

- 345 Kush para Kopernikut ybuloi se toka është e rrumbullaktë, se sillet rreth boshtit të vet dhe rreth diellit?
- Biruni.
- 346 Cilit prej As'habëve i ceket emri në Kur'an?
- Zejdit r.a.
- 347 Si quhet as'habi të cilin e lanë melekët si shehit?
- Handhele el-Ensari.
- 348 Sa vetë herën e parë u shpërngulën në Abisini dhe kush i udhëhoqi?
- 16 vetë dhe i udhëhoqi Othmai r.a.
- 349 Cili është emri i Ebu Bekrit?
- Abdullah ibn Othman ibn Amir.
- 350 Sa vetë i shin me Muhammedin a.s. në Umretu'l-Kada pas marrëveshjes së Hudejbijes?
- Dy mijë vetë.
- 351 Në cilin vit u pranua Islami si fe zyrtare në Belgjikë?
- Më 1974.
- 352 Në cilin vend ka udhëtuar Muhammedi a.s. me axhën e tij?
- Në Sham.
- 353 Cilët janë dy qytetet më të afërta të Mekkes?
- Xhiddeja dhe Taifi.
- 354 Si quhet As'habeja që mbante ujë në Uhud?
- Safijje bint Abdul Muttalib
- 355 Çka ka qenë morali i peygamberit a.s.
- Morali i tij ka qenë Kur'ani famëlartë.
- 356 Si na urdhëron peygamberi a.s. ndaj më të vjetërve si ndaj më të rinjve?
- Ndaj më të vjetërve me respekt, kurse ndaj të rinjve me mëshirë.
- 357 Islam është fe që për qëllim ka vetëm lumturinë personale ose jo?
- Jo. Islami është fe e cila për qëllim ka lumturinë e shoqërisë.
- 358 Përmendi disa gjunahe të mëdha?
- Shirku, zinaja, vjedhja, pirja e alkoolit etj.

359 Si quhet vendi ku lexohet hudbeja?
- Vendi ku lexohet hudbeja quhet Minber.

360 Cila sure fillon pa besmele?
- suretu Et-Teubeh.

361 Sa herë është përmendur besmelja në Kur'an?
- 114 herë.

362 Cila sure ka dy besmele?
- Suretu En-Neml.

363 Ç'është Sened?
- Zinxhiri i të transmetuarit të haditheve të Muhammedit a.s.

364 Si duhet thënë për punën të ciën e vendosim ta kryejmë?
- In shaa Allah.

365 Sa kat qiej ka krijuar Allahu xh.sh.?
- 7 kat qiej?

366 Cilat janë ato ajete që quhen Mekki?
- Ata që janë shpallur para hixhretit.

367 Cilat janë ato ajete që quhen Medeni?
- Ata që janë shpallur pas hixhretit.

368 Sa netë të mëdha ka dhe cilat janë ato?
- 5 netë: Lejletul-Kadr, Lejletul-Meulid, Lejletur-Regaib, Lejletul-Mi'raxh dhe Lejletul Berat.

369 Cila është sureja më e gjatë në Kur'an?
- Suretul-Bekareh.

370 Si quhet ndryshe sureja el-Fatiha?
- Um-mul Kur'an, (nëna e Kur'anit)

371 Si quhet sureja e fundit në Kur'an?
- Suretu en-Nas.

372 Çdo të thotë Hadith kudsij?
- Fjalë të shpallura Muhammedit a.s. nga ana e Allahut xh.sh. pa ndërmjetësimin e Xhibrilit.

373 Sa sure janë të emëtuara me emra të pejgamberëve?

- 7 sure: Junus, Hud, Jusuf, Ibrahim, Llukman, Nuh dhe Muhammed.

374 Sa herë në vit Xhibrili ia lexonte Muhammedit a.s. ajetet e shpallura?

- 1 herë në vit, ndërsa vitin që ndërroi jetë ia lexoi 2 herë.

375 Cila sure është zemra e Kur'anit?

- Ja'sini.

376 Cilat janë emrat e Kur'anit që i përmend Allahu xh.sh.?

- Tenzil, Kur'an, Furkan, Nur, Burhan, Huda, Bejan, Hak, Hakim.

377 Si është përkthimi i titullit të sures el-Hadid?

- Hekuri.

378 Cila sure është e shpallur e fundit në Kur'an?

- Sureja en-Nasr.

379 Në _____ mbretër. (W. Shakespeare)

- Në 7 mbretër.

380 Udhëtimi rreth tokës për _____ ditë. (J. Verne)

- Udhëtimi rreth tokës për 80 ditë.

381 Gruaja _____ vjeçare. (H. Balzac)

- Gruaja 30 vjeçare.

382 _____ kuartete. (T.S. Eliot)

- 4 kuartete.

383 _____ jetë. (G.Maupassant)

- 1 jetë

384 _____ persona e kërkojnë autorin. (L.Pirandello)

- 3 persona e kërkojnë autorin

385 Opera për _____ groshë. (B. Brecht)

- Opea për 3 groshë.

386 Përkujtimi për _____ të hëna. (A. Miller)

- Përkujtimi për dy të hëna

387 _____ motra. (A. Çehov)

- 3 motra.

388 _____ zezakë të vegjël. (A. Christie)

- 10 zezakë të vegjël.

389 _____ vjet vetmie. (G.G. Marquez)

- 100 vjet vetmie.

390 _____ këngë dashurie dhe _____ e dhimbshme. (P.Neruda)

- 20 këngë dashurie dhe 1 e dhimbshme.

391 Tregimi mbi _____ qytete. (Ch. Dickens)

- Tregimi mbi dy qytete.

392 _____ nën det. (J. Verne)

- 20 000 mila nën det.

393 _____ shokë lufte. (E.M.Ramarque)

- 3 shokë lufte.

394 _____ për fat. (A. Christie)

- 13 për fat.

395 Bilijardoja në _____ e gjysmë. (H.Boll)

- Bilardoja në 9 e gjysëm.

396 Kuleta prej _____ funtash. (M.Twain)

- Kuleta prej 1 000 000 funtash.

397 _____ vdekje. (L.Tolstoj)

- 3 vdekje.

398 _____ dhëmbë. (G.Grass)

- 32 dhëmbë.

399 _____ e _____. (V.Hugo)

- 90 e treshi.

400 _____ milionë. (O.Henri)

- 22,4 milionë.

401 Shërbëtori I _____ zotërinjve. (C.Goldoni)

- Shërbëtori i 2 zotërinjve.

- 402 _____ musketarë. (A.Dumas)
- 3 musketarë.
- 403 _____ ditë të Musa Dagh-ut (F.Werfel)
- 40 ditë të Musa Dagh-ut.
- 404 _____ javë në balonë (J. Verne)
- 5 javë në ballon.
- 405 _____ kalorësit e Apokalipsës (V.Blasco Ibanjez)
- 4 kalorësit e Apokalipsës.
- 406 _____ kusarë (L.Tolstoj)
- 2 kusarë.
- 407 _____ vjet (C.Alvaro)
- 20 vjet.
- 408 _____ ushtarë (D.Passos)
- 3 ushtarë.
- 409 _____ llulla (I.Erenburg)
- 13 llulla.